



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/107 Nr. i faq./Br.str./No.pg 84

Data/Data/Date 25.02.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHk) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 25.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, me nr. prot. 02/7007, i datës 10.2.2025 dhe merret vendimi për **caktimin** e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social.
2. Lokacioni për ndërtimin e objektit për banim social do të jetë në parcelën kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02172-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2261m² (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), Zona Kadastrale Rahovec, e evidentuar në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHk) 2023-2031, me nr. prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024 ka destinim: 5. Banim dhe 5.1. Banim i përhershëm.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrotjtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEÇ

01-Nr.107/26
Më dat:25.02.2026

